

Plagosja në Pejë, arrestohet një person i dyshuar



11/09/2022 09:21

f

🐦

🔗

Policia e Kosovës ka arrestuar një person të dyshuar për veprën penale “Vrasje e rëndë në tentativë”.

Sipas njoftimit të policisë, më datë 10 shtator rreth orës 20:50, policia është informuar se në fshatin Lutogllavë të Pejës, një person është plagosur nga arma e zjarrit.

Policia ka dalë menjëherë në vendin e ngjarjes, teksa viktimja e plagosur nga arma e zjarrit është transportuar në Spitalin Rajonal në Pejë nga ekipet mjekësore, ndërsa më vonë është dërguar në QKUK për trajtim të mëtejshëm.

Në shtëpinë e të dyshuarit për plagosjen është kryer bastisje nga zyrtarët policorë ku janë gjetur armë e municion.

Pas intervistimit, i dyshuari me vendim të Prokurorit është ndaluar për 24 orë.

Njoftimi i plotë:

Më datë 10 shtator 2022 rreth orës 20:50, Policia është informuar se në fshatin Lutogllavë- Pejë, një person është plagosur nga arma e zjarrit.

Policia menjëherë ka dalë në vendngjarje, aty është informuar se viktimja ishte i plagosur nga arma e zjarrit, në vendngjarje gjithashtu ka dalë edhe ekipi mjekësor të cilët me autoambulancë e kanë transportuar viktimën në Spitalin Rajonal në Pejë, dhe më pas për shkak të natyrës së lëndimeve i njëjti është dërguar në QKUK për trajtim të mëtejshëm mjekësor.

I dyshuari është larguar nga vendi i ngjarjes ne drejtim të panjohur.

Njësitet relevante kanë shkruar tek shtëpia e te dyshuarit, ku kanë kryer një kontroll- bastisje, gjatë kontrollit në shtëpinë e te dyshuarit është gjetur dhe sekuestruar një (1) armë Ak 47 (e modifikuar),

Pas një pune operativo-hetimore, është arrestuar i dyshuari, tek i njëjti është gjetur arma Pistoleta cal:7.65mm, një (1) fishek i gjallë dhe një (1) gëzhojë e së njëjtës arme, me të cilën dyshohet se është kryer vepra penale.

I dyshuari pas intervistimit me vendim të Prokurorit të shtetit ndalohet për 24 orë. [/Lajmi.net/](#)



Artikuj të ngjashëm



September 11, 2022
Krimineli Ratko Mlladiq shtrihet në spital



September 11, 2022
Çmimi që paguajnë nxënësit për grevën



September 11, 2022
Këshilltari i Kurtit rendit top-ngjarjet e Qeverisë, aty llogaritet edhe hapja...



September 11, 2022
Bislimi: Kosova ka potencial të madh zhvillimor



September 11, 2022
Popovci: Sistemi i vlerësimit të mësimdhënësve do të pësojë ndryshime



September 11, 2022
Miftaraj: Cilët janë ministrat më të dobët të qeverisë Kurti 2,...

Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information

RRJETET SOCIALE

